



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

Legjislatura e V  
Komisioni për Buxhet dhe Financa  
Mbledhja nr. 61/16  
Prishtinë, më 8.6.2016, ora 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA**

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Adem Grabovci, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri dhe Bardhyl Meta.

Munguan: Fikrim Damka, Bali Muharremi dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar: Agim Krasniqi- zv. Ministër i Financave, Besnik Osmani – Auditor i Përgjithshëm, Ismet Bexheti - Kryetar i Bordit të RTK-së, Mentor Shala - Drejtori i Përgjithshëm në RTK , Adelina Valla - Menagjere e Financave në RTK, Bashkim Bekaj - Udheheqës i Shërbimeve të Përbashkëta të RTK-së, Krenar Bujupi – Anëtar i bordit të ZRRE-së, Arsim Janova – nga ZRRE, Ejup Hasani nga ZRRE, Ismet Krasniqi - Sekretar i Kuvendit të Kosovës, Emrush Haxhiu dhe Istret Azemi – nga Kuvendi i Kosovës.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Rejhane Zylfijaj nga GIZ, Fjolla Uka - monitoruese në KDI, Leotrim Berisha - gazetar i Tribuna Chanel, Florina Ejupi – monitoruese e BIRN.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit;
3. Shqyrtimi i Vendimit nr.06/88, dt. 20.5.2016, të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpërndarjen e kontigjencës për korrektim të formulës-pjesës së Grantit të Përgjithshëm për vitin 2017 për komuna në vlerë prej 4,000,000 euro;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015;
5. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor të Radiotelezionit të Kosovës për vitin 2015;
6. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Zyrës Rregullative për Energji për vitin 2015;
7. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2016;
8. Të ndryshme.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari** – propozojë që rendi i ditës të plotësohet me një pikë shtesë: Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të Qarkorës Buxhetore 2017/01.

Në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni me pesë vota Për, dy Kundër dhe asnjë Abstenim, miratoi rendin e ditës me ndryshime: shtohet pika e re “Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të qarkorës buxhetore 2017/01”, si pika e 8 me radhë e rendit të ditës.

## **2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 17.5.2016, 19.5.2016 dhe 24.5.2016**

**Besa Gaxherri** – në lidhje me pikën plotësuese të rendit të ditës, dua të kyqem në procesverbalin e datës 24.5.2016, në pikën kur janë shqyrtuar kërkesat buxhetore të Kuvendit lidhur me rishikimin e buxhetit 2016, në të cilin nuk është diskutimi im, respektivisht kundërshtimi që kjo pikë të shqyrtohet në mënyrë të ngutshme, ku aty për aty e kemi marrë materialin. Po ashtu në votimin për këtë pikë është thënë se është votuar njëzëri, ndërkaq unë kam votuar kundër. Prandaj, kërkojë që të bëhen këto përmirësime në proceverbal.

Unë kam qenë kundër dhe jam kundër që edhe këtë pikë të shqyrtojmë me urgjencë. Ne duhet parasegjithash si Kuvend të respektojmë rregulloren dhe nëse ne e bëjmë një gjë të tillë, po japim shmebull jo të mirë edhe për organizatat tjera buxhetore, për të vepruar në këtë mënyrë.

**Kryetari** - konstatoi se komisioni miratoj proceverbalet e mbledhjeve të mbajtura të Komisionit, të datës 17.5.2016, 19.5.2016 dhe 24.5.2016, me vërejtjet e deputetës Besa Gaxherri, që duhet të inkorporohen në proceverbalin e datës 24.5.2016.

## **3. Shqyrtimi i Vendimit nr.06/88, dt. 20.5.2016, të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shërndarjen e kontigjencës për korrektim të formulës-pjesës së Grantit të Përgjithshëm për vitin 2017 për komuna në vlerë prej 4,000,000 euro**

**Kryetari** – theksoi se Qeveria e Kosovës ka nxjerrë një vendim për shërndarjen e kontigjencës për korrektim të formulës-pjesës së Grantit të Përgjithshëm për vitin 2017 për komuna në vlerë prej 4,000,000 euro, dhe është proceduar në Kuvend.

**Agim Krasniqi** - unë t’iu then të drejtën nuk e di pse ka ardhur ky vendim në Kuvend. Kanë qenë tri vendime paraprake të qeverisë të natyrës së tillë edhe asnjëherë nuk janë proceduar në Kuvend. Sa i përket arsyeshmërisë së këtij vendimi, në momentin që janë rritur pagat për 25%, tek struktura e buxhetit te nivelit komunal kanë qenë 80% për paga dhe më pak se 20% te pjesa e kapitaleve. Kjo rritje prej 25 % së pagave, komunat e caktuar i ka lënë fare pa kapitale. Duke e pas parasysh këtë gjendje të krijuar, komunat e mesme dhe të vogla nuk kanë mundur me i krye obligimet e tyre. Na si ministri e financave që me e tejklue këtë situatë kemi propozuar që të granti i përgjithshëm, një pjesë e rritjes me iu shpërnda komunave të mesme e të vogla dhe 12 komunave me iu nda shumë prej 2 milion euro që propocionalisht iu bie nga 142,000 euro dhe shumë tjetër prej 2 milion euro me e nda sipas numrit të popullatës. Komunat që përfshihen me këtë vendim janë: Hani i Elezit, Junik, Leposaviq, Mamushë, Novobërd, Shtërpc, Obiliq, Zubin Potok, Zveçan, Graçanicë, Klllokot, Mitrovicë e Veriut, Partesh dhe Ranillug. Ky propozim është miratuar në Komisionin e Granteve dhe është reflektuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Duke pasur parasysh faktin se me Ligjin për financat e pushtetit lokal është përcaktuar formula e ndarjes së granteve dhe për tu ekzekutuar ky vendim politik duhet krijuar bazën ligjore.

**Kryetari** – sqaroi se me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal, janë të përcaktuara kriteret, respektivisht formula për ndarjen e buxhetit apo granteve për komunat (nenet 23-25). Komisioni i Granteve është i obliguar që në pajtim me kriteret e përcaktuara me ligj, të propozojë ndarjet buxhetore, respektivisht grantin e përgjithshëm, dhe grantet specifike për arsim dhe shëndetësi për komunat. Nenin 33.a, ofron mundësinë ligjore për ndryshimet e formulës së granteve. Por, meqë formula e granteve është e përcaktuar në ligj, atëherë ndryshimet mund të ndodhin duke ndryshuar dhe plotësuar ligjin.

**Besa Gaxherri** - bazën ligjore që e sqaruar zv. ministër është ashtu siç e theksuat, por në anën tjetër kemi disa komuna siç është edhe rasti i Komunës së Junikut dhe kur kemi bërë një vizitë me kryeministrin në këtë komunë e kemi parë, që në qoftë se nuk e marrim një vendim të tillë, këto komuna kanë me falimentue sepse nuk kanë mundësi apo të hyra të mjaftueshme për shpenzimet elementare apo operative. Lidhur me këtë qështje kam një pyetje për Komunën e Mitrovicës Veriore, numrin e banorëve të regjistruar qenka 12,326 , në bazë të cilit regjistrim janë këto të dhëna dhe a është i saktë ky numër?

**Agim Krasniqi** – sqaroi se regjistrimi i popullsisë është bazuar në të dhënat zyrtare për regjistrimin e popullësisë.

**Safete Hadergjonaj** - nëse ka mundësi me na shpjegue se qka është ky korrektimi? Ne po shohim se janë propozuar 4 milion euro për me u nda për 14 komuna të vogla dhe po më intereson me ditë kah i keni marr këto 4 milion euro dhe janë dëmtuar komuna tjera dhe në nëse po ku janë dëmtuar, në qfarë pozicionesh dhe qysh ka ardhur deri te kjo zgjidhje? Po e shoh natyrën e problemit dhe ndoshta ne duhet ta përkrahim një vendim të tillë, mirëpo është vendim pa bazë ligjore dhe dhe si ti tillë nuk mund të ekzekutohet. Është dasht me intervenu më heret e me i ba ndryshimet në ligj, e ne mos me ra në pozicione të palakmueshme sepse në këtë moment ju e arsyetoni vendimin e juaj dhe thoni se e kemi dërguar në Kuvend, por ne si Kuvend jemi në pozicion të palakmueshme sepse në këtë formë po ta përkrahim bëjmë shkelje të ligjit.

**Agim Krasniqi** - siç e sqarove edhe më herët, komisioni i granteve e ka aprovuar një kërkesë të tillë. Në fakt ky 4 milion euro është ndarë në mënyrë propocionale. Po kërkojë prej juve që me mbështet vendimin e qeverisë dhe me thënë se për tu ekzekutuar duhet krijuar baza ligjore

**Kryetari** - jan dy qështje: E para nëse ky vendim shkon me rekomandimin e komisionit në seancë atëhere Kuvendi mund ta voton dhe por çdo gjë që Kuvendi e aprovon kthehet në ligj. E dyta është qe ne ti rekomandojë qeverisë se e përkrahim në parim propozimin, por tu ekzekutuar vendimi duhet krijuar baza ligjore, përmes ndryshimit dhe plotësimit të ligjit. Pra deri sa nuk krijohet baza ligjore ky vendim është i perealizueshëm.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni për Qeverinë e Kosovës, njëzëri e nxori këtë

### **Përfundim**

Komisioni për Buxhet dhe Financa, përkrahu në parim Vendimin nr. 06/88, dt. 20.5.2016, e Qeverisë së Republikës së Kosovës për shpërndarjen e kontigjencës për korrektim të formulës-pjesës së Grantit të Përgjithshëm për vitin 2017 për komuna, në vlerë prej 4,000,000 euro, dhe vlerësoi se ekzekutimi i këtij vendimi mund të bëhet pas krijimit të bazës ligjore, përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal.

#### 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015

**Kryetari** - në bazë të nenit të Ligjit nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës, Auditorit i përgjithshëm i ka dërguar Kuvendit raportin vjetor financiar për vitin 2015. Buxheti i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015 ka qenë 2,212,516 euro, pas rishikim buxheti ka qenë në shumë prej 2,160,805 euro, ndërsa buxheti përfundimtar ka qenë 2,233,919 euro, kurse buxheti i shpenzuar ishte 2,203,052 euro apo 99 %.

**Besnik Osmani** – theksoi se buxheti i ZAP-së është shfrytëzuar diku prej 99%, kryesishtë rreth 73% të këtij buxheti është bërë për rrogat e stafit dhe 26 % është shfrytëzuar për kosto operative. Sa i përket kostove operative më të mëdha janë shpenzimet për pagesën qerasë dhe 11% janë shpenzime për kontraktimin e firmave të licencuar për auditime për të cilat Zyra e Auditorit të Përgjithshëm nuk ka pas kapacitete në nivel të vetin me i auditu. Rreth 15% e buxhetit e kosto operative është shpenzuar për nevojat e auditorëve në teren për shkak të natyrës së punës. Zyra ka pasur 146 të punësuar, prej tyre ka pas dy zyrtar qe te cilat kanë punuar me kontratë mbi veper, njëri që është lidhur shërbimet korporative e tjetri për auditime specifike dhe kemi pasur katër zëvendësime të stafit për shkak te pushimit te lehonisë. Vlera e pasurisë kapitale është shumë vogël dhe sipas kriterëve sipas auditimit diku rreth 41,000, derisa 101,000 euro janë vlerë pasurive jokapitale. Me këtë buxhet të shpenzuar janë bërë një raport i auditimit të buxhetit, 89 raporte individuale të organizatave individuale, 16 auditime të performancës , 11 auditime të fondeve të auditoreve me kërkesë të tyre dhe 19 auditime të rregullsisë si faza të ndërmjetme.

**Kryetari** – në vitin e kaluar raportin financiar të auditorit e kemi kthyer për përmirësime, për shkak të gabimeve dhe mosaktësisë së të dhënave. Keni një përgjegjësi të re për rregullimin e qështjes së objekti të auditorit sepse ju paguni 175,000 euro që është një shumë e madhe dhe duhet të bëni përpjekje maksimale me Komunën e Prishtinë për me sigurue lokacionin për ndërtimin e objektit apo me Ministrin e Administratës Publike me ju sigurue hapësirë, për me zgjedhë problemin e objektit të përhershëm. Një pyetje tjetër është fjala për një qira të paisjeve në vlerë prej 20,414 euro, qfarë qiraje dhe për qfarë pasije bëhet fjalë?

**Besa Gaxherri** - unë ju uroj punën e re dhe vërejtjet janë pakuptim pasi që nuk keni qenë në detyrë në vitin 2015, por nuk mundet me kalue raporti pa i thënë vërejtjet e mija, duke pas parasysh se jeni një insitucioni me relevancë shumë të madhe për të gjitha organizata buxhetore në nivel të shtetit. Sa i përket tabelës së përgjithshme, buxheti fillestar është 2,12.516 euro, në rishikim është 2,160.805 euro, ndersa buxheti përfundimtar 2,233.919 euro, nuk e di si ka ndodhur kështu, prandaj kërkohet një sqarim? Në tabelën 4.c shpenzimet e udhëtimit tejkalohe krejt pa arsye dhe janë të pafalshme, dmth shpenzimet e udhëtimet zyrtare brenda vendit janë 108%, mëditjet e udhëtimit zyrtare brenda vendit 104%, akomodime zyrtar brenda vendit 111%, shpenzimet e udhëtimet zyrtar jashtë vendit 108%, mëditjet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit 113% , akomodimi zyrtar jashë vendit 107%? Pastaj dalim tek shërbime shtypi jomarketing që janë 116 %, e që nuk është e sqaruar, shërbime kontraktuese tjera 221%, kompjuterë me pak se 1000 euro janë 126%, furnizim ushqim e pije jodreka zyrtare është 117 %. Këto shpenzime përveç që nuk janë në rregull se janë tejkaluuar, janë edhe kode buxhetor që janë krejtësisht të paarsyeshme, dhe unë mendoj që më këtë raport në Kuvend nuk duhet kështu me shkue, dhe komisioni nuk ishe dashur këtë raport në këtë formë me aprovue. Në fund në tabelën 4g thuhet se stafi menaxherial e ka shenzuar buxhetin 17.1%, e që faktikisht realizimi është 100%, stafi auditor 71.5% e në fakt është 100% i shpenzuar, stafi administrativ 11%, e që është 100%. Unë besojë se është gabim teknik, por auditorit nuk i falet. Unë mendojë se edhe ky buxhet apo raport duhet të kthehet dhe të dërgohet me përmirësime.

**Safete Hadergjona** - sa i përket numrit të të punësuarve, keni raportuar se i keni 146 të lejuara ndërsa janë të punësuar 150, që paraqet një tejkalim të numrit të të punësuar, e që sipas ligjit nuk guxojmë me pas tejkalime të numrit të të punësuarve edhe pse në raportin financiar të qeverisë kemi parë se ka pasur tejkalime në disa komuna, por megjithatë jemi të prirur që disa lëshime të tilla të paktën mos të ndodhin tek auditori i përgjithshëm sepse ne sytë i kemi tek ky institucion, për të evidentuar dhe të ngrisë të gjitha parregullsitë që ndodhin tek institucionet tjera. Neve na intereson që auditori i përgjithshëm të na bëjë me dije për efikasitetin dhe efektshmërinë e shfrytëzimit të mjeteve financiare financiare nga ana e institucioneve të cilat financohen nga buxheti i Kosovës apo nga përgjithësi nga paraja publike. Përqindjet tek tabela 4g që kanë të bëjnë me pagat e stafit është mirë me u përmirësuar dhe me dhënë një arsyeshmëri se janë të kalkuluar në shumën e përgjithshme të mjeteve të ndara për paga dhe mandej është e kuptueshme si si ka rrjedhur në përqindje të tjera.

**Labino Ademi** - sa i përket shpenzimeve të mëditjeve e udhëtimit zyrtarë brenda vendit dhe jashtë vendit janë të barabarta, të planifikuara dhe të shpenzuara përafërsisht njëjtë. Në këtë drejtim, ajo çka me bërë përshtypje akomodimet për udhëtimet brenda vendit janë planifikuar 20,000 euro dhe janë të shfrytëzuara 19,000 euro, nderkaq jashtë vendit 9,500 euro, dmth më shumë shpenzime për akomodim brenda vendit se sa jashtë vendit? Po ashtu më bërë shumë përshtypje shërbimet e arsimit dhe të trajnimit në shumë prej 100,000 euro, a është ndoje trajnim eventual të kësaj natyre, pasi që është një shumë e madhe? Në anën tjetër kemi linjën buxhetore shërbimet intelektuale dhe këshillëdhënëse, a nuk ishte dashur që kjo të ishte te arsimimi? Përkundër të gjitha mëditjeve të shfrytëzuara, prap kemi avans për udhëtime zyrtare 60,000 euro, spo e kuptoj si ka ndodhur kjo, edhe më mëditje edhe avans shumëfish të shfrytëzuara? E kemi një shifër 2,000 euro për dreka zyrtare, të shpenzimet e përfaqësimit, kjo ndoshta mund të jetë edhe arsye që njerëzit nuk dëshirojnë të punojnë privat, pasi që në atë sektor marrin vetëm pagën, ndërsa në sektorin publik, përveq pagës po shfrytëzohen edhe këto mundësi, si dreka zyrtare, pije. Këto ishin qështjet e mija, që do të ishte me interes të kemi sqarime?

**Besnik Osmani** – në qështjet dhe pyejtet e ngritura nga deputetët, sqarojë se sa i përket udhëtimeve zyrtare brenda vendit këto janë për shkak të punës në terren që kanë auditorët dhe kjo është arsyeja pse janë këto shpenzime të mëdha brenda vendit. Pra mëditje nuk merren brenda vendit, por shpenzimet që kanë të bëjnë me qëndrimin, ushqimin dhe pijet gjatë punës në terren janë trajtuar si shpenzime të tilla. Me rregullore të brendshme është paraparë që për punën në terren auditori për këto shpenzime të ushqimit gjatë ditës që janë dikun janë 7 apo 8 euro në ditë. Në vitin 2015 kishte një kontratë që tri vjeçare që të marrim aparate fotokopjues dhe printera me qira gjatë punës në terren e faktikisht nuk janë paisje të auditorit por janë paisje të kontraktuara dhe kjo është një shumë e madhe në strukturën e buxhetit të shpenzimeve.

**Kryetari** - është shumë e pakuptueshme me marrë me qira paisjet dhe qështja që shtrohet, a është ma lirë për një vit me i marr me i qira paisjet apo me i ble dhe duhet të analizohet kjo arsyeshmëri e kostos dhe të keni parasysh për buxhetin tuaj në të ardhmen.

**Besnik Osmani** - unë i kam kërkuar edhe auditorit të brendshëm që me ma ba një vlersim krahasimor i të qënës pronar të këtyre paisjeve apo të marrurit me qira, për të parë koston. Në kuptimin funksional më mirë është që të jemi jashtë kemi sepse nuk brengosesh a funksionojnë vazhdimisht dhe mënyra e përlllogaritjes së kosotos është shumë e lehtë sepse në mënyrë automatike apo digjitale i sheh shpenzimet që po bënë dhe i paguan. Për skemat e çertifikimit është e vërtetë që është një shumë e madhe që përveç kostove për kryerjen e provimeve për teknik i kontabilitetit dhe si auditor, që mbahen nëpër shoqata të profesionalizuara, ka edhe një pagesë për anëtarisme vjetore për secilin prej tyre që një shumë e madhe në bazë të një standardi të cilin e ka caktuar bordi i pavarur i kontrabilitetit. Zyra e auditori e ka paguar çertifikimin dhe anëtarimin në mënyrë që mos të humbë licenca sepse është e paraparë me ligjet e Kosovës. Sa i përket objektit, në takimet që kam pasur me kryetarin e parlamentit dhe kryeministrin, e

kam ngritur këtë qështje, pasi që kam dështuar për të gjetur një zgjidhje me Ministrin e Administratës Publike, dhe si objekt i mundshëm për vendosje është dikskutuar ish objekti që ka qenë e vendosur OSBE-ja. Por ajo që kemi bërë është zbritja e qerasë dhe si rezultat do të kemi kursime për 30,000 euro. Në tabelat e prezantuara në raport janë disa paraqartësi që i kam ngritur edhe vet, pasi që në buxhet janë futur edhe donacionet për pagesën e një këshilltari dhe kjo ka shkaktuar një mospërputhje me buxhetin e rregullt dhe në strukturën e buxhetit. Megjithë faktin se po vërehen gabime teknike, nëse ju më lejoni unë isha konsultuar me stafin dhe e kisha sjellur një raport tjetër të përmirësuar dhe nuk do të deshiroja që raporti me shkue me gabime.

**Adem Grabovci** – si auditor i përgjithshëm ke një përgjegjësi jashtëzakonisht të madhe dhe unë uroj që në të ardhmen raportet e këtij institucioni të jenë shumë më pozitive në këtë aspekt duke ditur rëndësinë e këtij institucioni kërkohet edhe profesionalizëm më i madh. E kam parasysh se e keni pranuar detyrën rishtazi, por unë pajtohem me vërejtjet e kolegëve se vërtetë ka një shpërputhje në raport me gabime teknike, dhe ne mund ta përkahim raportin dhe ta procedojmë në Kuvend dhe gjatë raportimit në Kuvend mund ti ngritni këto qështje.

**Safete Hadërgjonaj** - zakonisht kur planifikohet buxheti nuk planifikohet avans në buxhet, nuk ka ndonjë linjë të pozicionuar për avans dhe kur ndodhin avanset, ato duhet mbyllur në fund të vitit dhe nuk duhet të figurojë në vitin tjetër. Prandaj nuk është mirë që në raport është prezantuar shuma e planifikuar dhe shpenzuar e avansit.

**Besa Gaxherri** - duke pasur paasysh rëndësinë e këtij institucioni unë mendojë se nuk duhet që këtë raport ta procedojmë në Kuvend, por të dërgoni një raport tjetër me të dhënat e përmirësuara. Me rastin e shqyrtimit të raportit të agjencioneve tjera ne duhet të bazohen në raportin tuaj, prandaj, duhe të shikoni edhe njëherë mirë dhe nuk kam dëshirë që raportin i këtij institucioni të del keq dhe me gabime.

**Besnik Osmani** – sa i përket numrit të të punësuarve nuk ka mbipunësim. Janë të punësuar 146 persona, numri tjetër është për shkak të zëvendësimeve për pushime të lehonisë. Madje, përkundër asaj që jam zgjedhur nga Kuvendi unë nuk do të marr rrogë sepse nuk ka vend të lirë në buxhet dhe kjo duhet të rregullohet me rishikimin e buxhetit.

**Kryetari** – nëse kërkesa është që të dërgohet një raport me të dhënat e përmirësuar sipas vërejtjeve që u ngriten, unë rekomandimin nuk mund ta nënshkruaj derisa të dërgohet raporti i përmirësuar.

**Bardhyl Meta** – nuk po kam dëshirë që imazhi i auditorit të ri me u dëmtue për shkak të një raporti që ka të bëjë me të kaluarën kur nuk keni qenë në detyrë. Propozimi im është që ti japim pak koh auditorit, që të rishikojë raportin dhe të dërgohet raporti me përmirësimet e nevojshme.

**Kryetari** – propozojë që komisioni ta miratojë Raportin vjetor financiar të ZAP-së për vitin 2015, dhe ZAP-ja të dërgojë raportin e përmirësuar dhe në Komision, i cili pastaj pas vlerësimit i bashkangjitet rekomandimit të komisionit me rastin e procedimit të tij në Kuvend.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoj se Komisioni nxori këtë,

### **Rekomandim**

- I. Komisioni përkrahu Raportin vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2015 i rekomandon Kuvendit për miratim.

- II. Kërkohej nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm që të dërgojë Raportin vjetor financiar të përmirësuar, i cili i bashkangjitet rekomandimit të komisionit, me rastin e procedimit të tij në senancë plenare.

## 5. Shqyrtimi i Raportit Financiar vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2015

**Kryetari** - në bazë të nenit 30 paragrafi 8 dhe 9 të Ligjit mbi RTK-në, Bordi i RTK-së është i detyruar që për punën e tij njëvjeçare, t'i raportoj Kuvendit të Kosovës si themelues i saj.

**Ismet Bexheti** - fokusi i punës së RTK-së gjatë vitit ishte përmbajtësor në funksion të programeve të reja duke iu përmbajtur standardeve profesionale të gazetarisë, përmirësimin e teknologjisë me forma mbështetëse financiare. Problemi kryesor i RTK-së është prona dhe financimi, për të cilat probleme kërkojmë ndihmë nga Kuvendi, gjithashtu digjitalizimi i RTK-së, për të cilin proces kërkojmë ndihmë financiare nga Qeveria, sepse kjo nuk është vetëm në interesin tonë, por në interesin publik.

**Mentor Shala** - pavarësisht vështirësive financiare, RTK-ja ka operuar në mënyrë mjaft të suksesshme gjatë vitit 2015. Prej buxhetit të përgjithshëm, të planifikuara kanë qenë 12,868.500 Euro, të shpenzuara 12,318.000 Euro, ndërsa të realizuara nga aktivitete tjera janë 12,478.000 euro, gjë që tregon se kemi pas bilanc pozitiv, por nuk nënkupton që kanë mbetur para, pasi që kërkesat janë dyfish më të mëdha, dhe se për këtë kemi dërguar kërkesa për një projeksion buxhetor, ku parashihet që buxheti i RTK-së të jetë më i lartë.

**Adelina Valla** - prej të hyrave të marketingut në shumë prej 1,900.000 Euro, janë inkasuar 2,228.851 Euro, për shpenzimet e rimbursimit, qirasë, vendosjes së antenave janë shpenzuar 481,450.00 Euro, për vitin 2015 RTK-ja ka inkasuar mjete në shumën prej 610,000.00 Euro apo 5.14%. Si mbulesë e vijave kutiguriale janë shpenzuar 5,495.000 Euro nga inkasimi. Për paga dhe medijtë kanë qenë të parapara 5,495.000 Euro, kurse janë realizuar shpenzime prej 6,012.000 Euro, që paraqet një tejkalim buxhetor prej 9%, kryesisht për shtimin e stafit në programet RTK1, RTK 2, RTK3 dhe RTK4. Kategoria mallra dhe shërbime ka pas tejkalim prej 4.14% në vitin 2015, shërbimet publike 230,000 Euro sa kanë qenë të parapara, 229,000 janë të realizuara apo 99.5%, investimet kapitale 1,300,000 Euro kanë qenë të parapara, kurse 1,033.000 Euro të shpenzuara apo 80%. Tejkalmi në të gjitha kategoritë është 3.79%, i cili është mbuluar me të hyrat vetanake.

**Besa Gaxherri** - pasqyra financiare e RTK të audituar nga auditorë të pavarur, opinionet e të cilëve mbi këto pasqyra kanë qenë të kualifikuara për kërkesën dhe tatimin mbi vlerën e shtuar. Megjithatë raporti i auditimit nuk trajton qështjet si borxhi apo problemet që e dijmë se ballafaqohet ky televizion. Ne duhet ta shohim saktë prej auditimit sa është borxhi, ku është borxhi, për të cilat ne kemi ngrit qështje, por duke mos marr përgjigje konkrete. Është e vërtetë se problem, edhe për mua, shumë i paarsyeshëm është prona, për të cilën nuk kemi punuar me hapa më të shpejt për ta zgjidhur. Në aspektin e shpenzimeve buxhetore, dua të flas për tejkalmimet buxhetore të pagat dhe medijtë, por sidomos edhe për numrin e lartë të punëtorëve dhe mos projektimin e buxhetit nga Drejtori i Përgjithshëm. Është e vërtetë që sipas sondazheve, performanca e televizionit publik është me e mirë se e televizioneve tjera, ani pse është e paarsyeshme që të ketë numër shumëfish më të lartë të punëtorëve se sa televizionet tjera, që për pasojë të këtij numri të lartë mungojnë mjetet për investimet kapitale.

Të hyrat nga buxheti, marketingu dhe të hyrat tjera është mirë që janë inkasuar më shumë, por është një ligj që përcakton se për sa guxon televizioni të bëj marketing, sepse ka një dallim me televizionet e tjera. Fakti që keni diferencë pozitive prej 160,000 Euro më shumë do të thotë se keni pas një sukses, por borxhi i akumuluar duhet të shqyrtohet. Duhet që menaxhmenti, bordi dhe politikat e bordit të rregullojnë qështjen e numrit të punëtorëve, pasi që një pjesë e madhe e buxhetit shkon për paga dhe medijtë. Numri është 700 punëtorë, dhe krahasuar me televizionet tjera që kanë nga 100 punëtorë, është

tejet i madh. Shpenzimet operacionale të Bordit kanë qenë 223%, prej 12,000.00 Euro të planifikuara janë shpenzuar 26,000.00 Euro.

**Kryetari** - kush konsiderohet pronar i pronave të RTK-së?

**Mentor Shala** - AKP-ja, një pjesë, pjesa tjetër përballë Kuvendit, d.m.th. pronësi mikse.

**Adem Grabovci** – theksoi se është absurditet që televizioni i shtetit në pronë të shtetit paguan qira.

**Bardhyl Meta** - komisioni pati formuar një grup pune për RTK-në, dhe nga kryeministri e kam pas për detyrë për të hartuar një koncept për disa qështje që duhet rregulluar për këtë televizion. Çështja e pronës asnjëherë nuk është marr seriozisht për tu trajtuar. Infraskrutura ligjore na mundëson ndryshimin apo modifikimin për me e kry parapagimin për televizionin përmes kontratës me KEDS-in, Borxhi i RTK-së prej 4.5 milion euro po bartet ndër vite, pastaj për problemin e digjitalizimit, parashihen 5-6 milionë euro me variante të ndryshme, apo edhe bashkëpunimin me VALA. Te çështja e pronës është mundësia që të zgjedhet një vend e mirë nga AKP-ja, që ta blej atë Qeveria, të marr një kredi ndërkombëtare të butë, që e garanton Qeveria, dhe të ndërtohet objekti për RTK-në. Sa për buxhetin, kur është vendos për shtimin e programeve për komunitetet, është dashtë me u shtu 10% e buxhetit në këtë aspekt, pavarësisht kërkesave të mëdha, që mendojë se kjo pjesë është dëshmuar e sukseshme në integrimin e komuniteteve.

**Adem Grabovci** - nëse televizionet private që janë te vendosura në objektet e Radio Kosovës, nuk kanë paguar qira, atëherë ata duhet të konsiderohen si uzurpatorë. RTK-së duhet t'i sigurohet një pavarësi financiare. Nëse konstatojmë se është në interes të mediumit t'i ndërtojmë objekt të ri, në rregull, por mendoj se duhet të shfrytëzohen pronat ekzistuese, e shoh si dështimin tonë që nuk e kemi zgjidhur këtë problem.

**Mentor Shala** - fakti që është shtuar programi RTK 2 në gjuhën serbe, automatikisht televizioni ka pas nevojë për 100 punëtorë serbë. Kurse sa për pjesën tjetër të punëtorëve ka prej atyre mund të them 100 - 200 që nuk punojnë edhe sa duhet, sepse ndoshta edhe për shkak të moshës nuk janë inkorporuar në teknologji, pjesa tjetër që inkuadrohet vjen si shkak që disa kalojnë në pension. Kurse sa i përket marketingut, kryesisht ne i servojme publikut atë që kërkohet më shumë, p.sh. sporti dhe serialet vendore, të cilat kanë rrit shikueshmërinë. Me ligj detyrohemi të shfaqim 10% marketing nga programi i tërësishëm. Borxhet janë të trashëguara nga viti 2011, përcillen vit pas viti, dhe në pamundësi financiare nuk mund të paguhen.

**Kryetari** – propozojë që komisioni ti rekomandojë Kuvendit, miratimin e raportit vjetor financiar të RTK-së për vitin 2015.

Pas disuktiveve dhe propozimeve, Kryetari konstatoj se Komisioni nxori këtë,

### **R e k o m a n d i m**

I rekomandohet Kuvendit të miratoj Raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2015.

## **6. Shqyrtimi i Raportit Financiar Vjetor i Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2015**

**Kryetari** - në bazë të nenit 9 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kryesuesi i ZRRE-së i dërgon Kuvendit të Republikës së Kosovës çdo vit raportin vjetor, jo më vonë se 3 muaj pas përmbylljes së vitit kalendarik.

**Krenar Bujupi** - buxheti i ZRRE për vitin 2015 ka qenë 680,000 Euro. Gjatë këtij viti janë bërë shkurtime buxhetore në paga dhe meditje, ku prej shumës totale të buxhetit janë shpenzuar 544,149.00 Euro apo 96.28%. Probleme kemi pas kryesisht me të hyrat e rregullatorit, të cilat kanë qenë të dedikuara vetëm për Zyrën e Rregullatorit, kurse sa i përket kritikave që kemi pas nga Komisioni rreth të hyrave shtesë të ZRRE, draftligji e parasheh që taksat e mbledhura të cilat i tejkalojnë parashikimet e Rregullatorit derdhen në buxhetin e shtetit. Për shkak të legjislacionit, që e ka pamundësu mbledhjen e të hyrave nuk kanë mundur të mbledhen 852.000 Euro, të cilat janë liruar të licensuara nga taksat, që ndikojnë pozitivisht drejtpërdrejt te konsumatorët.

**Besa Gaxherri** - në cilin ligj jeni bazuar për t'i liruar të licencuarit nga pagesat e licencave? Kam ngrit edhe çështje parlamentare sa i përket humbjeve nga vjedhja, në një Komision kam dëgju një përgjigje nga ju se Ligji nuk e ndalon që konsumatorët e ndershëm të paguajnë për konsumatorët që vjedhin energjinë elektrike, ku bazoheni në këtë, në cilin ligj, edhe pse jeni të vetëdijshëm se konsumatorët e ndershëm paguajnë qoftë për komunitetet tjera indirekt, edhe për ata që vjedhin? Sa i përket realizimit buxhetor që është 96.28%, ju nuk duhet të dilni jashtë planifikimit buxhetor pasi që asnjë kod buxhetor nuk lejon diçka të tillë, për më tepër shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, akomodimit, e të tjera, i keni tejkualuar? Shpenzimet e arsimit dhe trajnimit i keni tejkualuar gjithashtu, dhe nuk keni shënuar përqindjen e saktë, këto janë vërejtjet në tabelat buxhetore, të cilat duhet të jenë të sakta.

**Kryetari** - përgjigjen në pyetjen e parashtruar mund ta jap edhe unë. Në kreun IV, Financimi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, në nenin 18, 21 dhe 22, thuhet se taksat e inkasuara nga ZRRE në lidhje me licencimin e aktiviteteve tjera në bazë të nenit 22 të Ligjit do të jenë të hyra të dedikuara për ZRRE, përveç kësaj ZRRE-ja mund të shfrytëzoj ndarjet buxhetore sipas kushteve të nenit 22, nëse nuk ju mjaftojnë.

**Krenar Bujupi** - rregullatori ka arritur që të caktoj sa janë humbjet në sistemin energjetik të Kosovës nga viti 2011. Pasi që janë caktuar humbjet, Rregullatori ka marr vendim se i licencuari është i obliguar t'i ul humbjet për 3%. Zbritja e humbjeve komerciale edhe teknike është e lartë, si ZRRE mendojmë se humbjet shkaktohen dhe duhet ta paguhen nga sektori energjetik. Alternativa tjetër është që ato të paguhen nga Qeveria e Kosovës.

**Bardhyl Metaj** - në vitet që është privatizuar KEDS-i, sa ka qenë obligimi i tij me investu, sa kanë qenë investimet dhe sa ka qenë impakti i humbjeve, sepse pjesën e humbjeve duhet ta mbuloj KEDS-i, asesi qytetari, aq ma pak Qeveria, për shkak se indirekt ngarkohen qytetarët?

**Krenar Bujupi** - nuk është në kontroll të KEDS-it me i ul humbjet komerciale, por në kompetencë të saj është rritja e përgjegjshmërisë dhe inspektimit, mirëpo humbjet ndodhin kryesisht për arsye që lidhen me gjyqësorin.

**Adem Grabovci** - humbjet janë të papranueshme dhe përgjegjësitë duhet ta marr dikush, dhe jo t'i rëndohen qytetarit, ju si ZRRE jeni të obliguar për përgjegjësi ndaj Parlamentit, ju duhet të merrni vetë iniciativën për plotësim-ndryshim të Ligjit, që qytetari të mos dëmtohet dhe të ruhet shteti.

**Kryetari** – propozojë që komisioni ti rekomandojë Kuvendit, miratimin e raportit vjetor financiar të ZRRE-së për vitin 2015.

Pas disuktimeve dhe propozimeve, Kryetari konstaton se Komisioni nxori këtë

## **R e k o m a n d i m**

I rekomandohet Kuvendit të miratoj Raportin vjetor të Zyrës Rregullatore për Energji për vitin 2015.

### **7. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2016**

**Kryetari** – propozoj që të miratojmë raportin tre mujor të shpenzimeve të Kuvendit dhe t'i rekomandojmë Kryesisë së Kuvendit për miratim.

Në bazë të propozimit, Kryetari konstaton se Komisioni njëzëri nxori këtë

## **R e k o m a n d i m**

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të miratojë Raportin e Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2016.

### **7. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të qarkores buxhetore 2017/01**

**Besa Gaxherri** - për çfarë arsye nuk është bërë kompensimi i veturavë të thyera të 4-5 deputetëve, për të cilat kemi sjell dëshmi, dhe është aprovu në Komision , dhe janë kalu të gjitha procedurat. Pse nuk është bërë kompensimi i dëmit?

**Naser Osmani** - kuvendi ka sigurimin e vet, policinë dhe masat e duhura të cilët duhet të ruajnë veturat në parking, sigurinë e tjera, përderisa deputetët janë në mbledhje apo seancë.

**Adem Grabovci** - duhet shikuar në zyrën ligjore a ka sigurim Kuvendi, të kompensohen drejtë dëmtimet e veturave.

**Ismet Krasniqi** - sa i përket dëmtimit të veturave, ajo është çështje dhe përgjegjësi e stafit të sigurimit dhe Kuvendi nuk merr asnjë përgjegjësi juridike në këtë rast. Nuk ka bazë juridike dhe është standard legjislativ. Vetëm ndërtesa e Kuvendit është e siguruar, kurse parkingjet jo.

**Bardhyl Meta** - sigurimi i ri për vitin 2017 duhet të përfshijë edhe sigurimin e jetës së deputetit, jo vetëm të ndërtesës apo parkingjeve.

**Safete Hadërgjonaj** - me qarkoren buxhetore janë zvogëluar mjetet tek investimet kapitale, pagat, mallrat dhe shërbimet. Në bazë të analizave të bëra me stafin e administratës, qarkorja nuk mundet me ndryshu dhe duhet të mbetet e tillë, do të qëndrojmë në kërkesat që janë miratuar në Komision me rastin e shqyrtimit të KASH-it të Kuvendit dhe kanë kaluar në Kryesi.

**Kryetari** - qëndrojmë pranë kërkesave tona dhe mos të ketë kërkesa shtesë në momentet e fundit.

**Ismet Krasniqi** - Kryesia e Kuvendit ka marr vendim që pas rishikimit të buxhetit të hap 4 pozita të reja pune për persona me nevoja të veçanta konform Ligjit mbi Shërbimin Civil. Në qarkoren buxhetore që e keni marrë nuk janë përfshirë këto pozita dhe prandaj duhet edhe të plotësohen.

**Kryetari** - propozoj që të miratohen kërkesat buxhetore të Kuvendit sipas qarkoresë buxhetore 2017/01 të përgaditura nga Grupi Punues i Komisionit dhe administrata e Kuvendit që kanë kërkesa të

ngashme me ato që kemi miratuar me KASH, me korigjimin për për 4 pozita të reja për personat me aftësi të veçanta.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni, njëzëri e nxori këtë

### **R e k o m a n d i m**

I rekomandohet Kryesisës së Kuvendit të miratojë kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2017-2019, sipas dokumentit të bashkangjitur këtij rekomandimi dhe Kryesia t'i rekomandojë Ministrisë së Financave, që të njëjtat kërkesa, ti përfshijë në linjat buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2017-2019.

**Mbledhja përfundoi në ora 14:14**

**Përgatitur nga:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Naser Osmani**